



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 4 i Regj. Themeltar
Nr. 4 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Ilir PANDA	Kryesues
Albana BOKSI	Anëtare
Klodian KURUSHI	Anëtar

sot në datë 15.06.2021 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale, që i përket:

KËRKUES: Agron Çela

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. 10-2021-745 (127) datë 20.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës, për kërkuesin Agron Çela.

BAZA LIGJORE: Neni 417 i Kodit të Procedurës Penale

Në çështjen penale me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

KUNDËR: Kevin Mburimi, Jaho Pura, Genci Kokonozi, Ilmi Kapedani, Romario Kapedani, Agron Çela

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe municionit”, “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe municionit”, në bashkëpunim, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, “Kultivimi i bimëve narkotike” parashikuar nga nenet 278/6, 279/2, 284, 283/2 të Kodit Penal

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtares Albana Boksi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 401, datë 09.09.2020**, ndër të tjera ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Çela për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 8 vite burgim.*

Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar përfundimisht me 5 vjet e 4 muaj burgim.”

2. **Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 127, datë 20.04.2021**, ndër të tjera ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. (11-2020-3774) 401 datë 09.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.”*

3. Kundër vendimit nr. 127, datë 20.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur rekurs, kërkuesi Agron Çela, me anë të së cilit ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 127 datë 20.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në gjykatën që ka dhënë vendimin.

4. Kërkuesi Agron Çela, në datën 31.05.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 127 datë 20.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës, duke parashtruar këto shkaqe:

- I pandehuri Agron Çela ka qëndruar për një kohë të gjatë në paraburgim, ka vuajtur nga sëmundje të ndryshme që ka rënduar shëndetin e tij dhe qëndrimi i tij i mëtejshëm në burg do të sillte pasoja të pariparueshme për shëndetin e tij.
- I pandehuri është kryefamiljar, ka bashkëshorten dhe tre fëmijë, ku njëri është i mitur që vazhdojnë shkollën dhe kanë nevojë për përkrahje ekonomike dhe edukim. Nëna e tij, Lahe Çela është e moshës 85 vjeç dhe vuan nga sëmundje të ndryshme dhe ka nevojë për përkujdesje shëndetësore të vazhdueshme.
- Agron Çela ushtron aktivitet privat ku ka të punësuar tre punëtorë.
- Jemi para rastit që Gjykata e Lartë duhet të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim sipas nenit 417 të K.Pr.Penale, pasi ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit sjell pasoja të rënda për kërkuesin dhe familjen e tij.

5. Bashkangjitur kërkesës për pezullim janë paraqitur rekursi, vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe apelit dhe një kopje e prokurës.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa e kërkuesit Agron Çela për pezullimin e vendimit penal nr. 127, datë 20.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës nuk është e bazuar në ligj.

7. Paraprakisht vlen të evidentohet fakti i ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi në datën 29.05.2021. Në nenin 38 të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore parashikohet se, *“1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekursi e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre”*. Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

8. Në rastin konkret, kërkesa e kërkuesit Agron Çela për pezullimin e ekzekutimit është depozituar në Gjykatë të lartë në datë 31.05.2021, ndërkohë që kishin hyrë në fuqi ndryshimet e KPP, me ligjin 41/2021. Aktualisht, neni 417 i Kodit të Procedurës Penale

parashikon: “Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Në rastet e rekursit, vendimi mund të pezullohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vetëm në rastet e parashikuara nga pika 1 e nenit 476 të këtij Kodi.”

9. Ligji ka parashikuar të drejtën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që në ato raste kur ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs, të pezullojë ekzekutimin e vendimit, vetëm sipas parashikimeve taksative të nenit 476/1 e Kodit të Procedurës Penale. Neni 476/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon rastet e shtyrjes së ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga gjykata që ka dhënë vendimin: “Gjykata që ka dhënë vendimin e dënimit, me kërkesën e të dënuarit, të mbrojtësit ose të prokurorit, mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në këto raste:

a) kur i dënuari vuan nga një sëmundje që pengon ekzekutimin e vendimit. Ekzekutimi shtyhet gjer në shërimin e të dënuarit;

b) kur e dënuara është shtatzënë ose me fëmijë nën një vjeç. Ekzekutimi shtyhet gjer sa fëmija të bëhet një vjeç;

c) kur vuajtja e menjëhershme e dënimit mund të sjellë pasoja të rënda për të dënuarin ose familjen e tij. Shtyrja e ekzekutimit në këto raste nuk mund të zgjatet më tepër se gjashtë muaj;

ç) në çdo rast tjetër që çmohet nga gjykata si i veçantë, duke u shtyrë ekzekutimi gjer në tre muaj.”

10. Kolegji vlerëson se, rastet e mësipërme janë taksative dhe Kolegjit Penal i lind e drejta të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit vetëm kur kërkuesi provon ekzistencën e njërit prej rasteve të referuara në këtë dispozitë. Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka argumentuar dhe as ka provuar të ndodhet në ndonjë nga rastet që justifikon pezullimin e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 467/1 të K.Pr.Penale. Pretendimi i kërkuesit se, ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit sjell pasoja të rënda për kërkuesin dhe familjen e tij, është një pretendim i paargumentuar dhe për më tepër i pabazuar në prova. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se, kërkuesi nuk ndodhet në ndonjë situatë apo rast që mund të vlerësohet si i veçantë dhe që të justifikojë pezullimin e vendimit, sipas pikës ç) të nenit 476/1 të K.Pr.Penale.

11. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Agron Çela për pezullim të ekzekutimit të vendimit penal nuk është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 417 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Agron Çela për pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. 127 datë 20.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës.

Tiranë, më 15.06.2021

A N Ë T A R

Klodian KURUSHI

A N Ë T A R E

Albana BOKSI

K R Y E S U E S

Ilir PANDA